

2

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 1-rë e rendit të ditës – Miratimi i rendit të ditës.

Elvi Cuni – Sekretar i Këshillit Bashkiak

Bën apelin e këshilltarëve. Marrin pjesë 41 anëtarë të këshillit bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pershendetje të gjithëve. Mirëseerdhët në këtë mbledhje të datës 31 tetor. Sipas apelit të bërë nga sekretari janë anëtarë të këshillit bashkiak. Kuorumi është vazhdojmë mbledhjen, Kalojmë me miratimin e rendit të ditës. Kush është dakord?

E hedh në votim rendin e ditës.

Këshilli bashkiak me **29 vota pro**, kundër, abstenim nuk ka miraton sa më sipër.

V.O. (12 këshilltarë të opozitës nuk kanë votuar - Doris Madhi, Armonela Marku, Valbona Balliu, Dritan Cepa, Artan Kana, Ergys Muzhaqi, Rudina Mita, Mimoza Trimi, Amarda Murati, Aurora Domni, Bjanka Copja, Altin Mecja).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 2-të e rendit të ditës – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit tetor (05.10.2023).

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Nuk i kemi proces verbalet në dosje.

Livia Guri – Juriste e sekretariatit të këshillit bashkiak.

Proces verbali ju është dërguar me e-mail gjithë këshilltarëve.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Proces verbalet janë dërguar me e-mail. Besoj i keni lexuar.

E hedh në votim pikën e dytë të rendit të ditës.

Këshilli bashkiak me **29 vota pro**, kundër, abstenim nuk ka miraton sa më sipër.

V.O. (12 këshilltarë të opozitës nuk kanë votuar – Doris Madhi, Armonela Marku, Valbona Balliu, Dritan Ceca, Artan Kana, Ergys Muzhaqi, Rudina Mita, Mimoza Trimi, Amarda Murati, Aurora Domni, Bjanka Copja, Altin Mecja).

Mbajtëse Proces verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 3 dhe 3/1 e rendit të ditës

Pika 3-të e rendit të ditës – Dhënia e Ndhmës Ekonomike nga fondi Bashkisë për muajin Shtator 2023.

Pika 3-të e rendit të ditës – Dhënia e Ndhmës Ekonomike nga fondi kushtëzuar për muajin Shtator 2023.

Shefqet Bullari – Kryetar i Komisionit të Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike.

Në komision nuk ishte kourumi i duhur por s’ka nevojë për vendimmarrje. Ne gjithsesi u njohëm me materialet dhe jemi dakord.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Ashtu sic u diskutua edhe atë ditë në mbledhjen kur kishim komisionet, unë besoj që fakti që keto komisione ekzistojnë dhe kanë një funksionalitet, ne duhet të kemi vizualitet mbi materialin, ta diskutojmë materialin paraprakisht që edhe nëse do e kalojmë këtu në këshill ta kalojmë pa probleme. Besoj se ekzistenca e këtyre komisioneve duhet të jetë reale, nuk duhen neglizhuar dhe ashtu sic ju kërkova dhe atë ditë, komisioni i ekonomisë është shumë i rëndësishëm, dhe i buxhetimit, kështu që o duhet të merrni masa për pjesëmarrjen e këshilltarëve në komision, ose duhet të ndryshoni përbërjen e komisionit, sepse mua nuk më duket aspak serioze anashkalimi i këtij institucioni brenda këshillit bashkiak. Këtu sot ka vendime shumë të rëndësishme përveç ndihmës ekonomike që të gjithë jemi

dakord në parim, apo për dëmshtëpërblimet për diegiet nga zjarret, ka të tjera vendime për tu marrë që janë shumë të rëndësishme, të cilat po nuk u diskutuan paraprakisht nuk ka si të kalohen për t'u marrë vendim në këshill.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Në parim jam dakord me shqetsimin që ju ngrini. Unë vetë kam kontaktuar me të gjithë këshilltarët, dhe disa më thonë se kanë arsye, disa jo, por ata duhet të thonë nëse kanë nevojë edhe për cdo arsye ne mund te shtymë ose të ndryshojmë oraret ose ditën..

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Të krijohet një komision “back up” ku të ndryshohen anëtarët në raste të tilla. Nuk është hera e parë, por është hera e tretë që ndodh kjo gjë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Do i japim zgjidhje këtij shqetësimi, për pjesëmarrje në komisione.

Rexhep Kaculi – Kryetar i Komisionit te Shërbimeve dhe Strehimit Social, Shëndetësisë dhe Barazisë Gjinore.

Komisioni i pa dhe ishte dakord me to. T'i hedhim në votim.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

I hedh në votim 2 materialet e ndihmës ekonomike.

Këshilli bashkiak me 41 vota pro, kundër, abstenim nuk ka miratohet sa më sipër.

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 4-tërt, e rendit të ditës - Miratim për marrje me qera dhe rinovim kontratash, të ambjenteve për tu përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Nuk kemi kourum.

Shefqet Bullari – Kryetar i Komisionit të Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike.

Këto janë ambjente që merren me qera dhe janë të shfrytëzueshme.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Lexon materialin e pikës 4.

E hedh në votim materialin e pikës 4.

Këshilli bashkiak me **39 vota pro**, 1 kundër, 1 abstenim miraton sa më sipër.

Votoi kundër – Aurora Domni

Abstenoj – Doris Madhi

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 5-të e rendit të ditës - Marrje me qera ambjent/sallë (rinovim kontrate) për të zhvilluar mbledhje të Administratës së Bashkisë.

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak.

Ka një afat të caktuar?

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë Elbasan

Ka një kontratë për marrjen me qera të këtij ambjenti, por është në varësi sa herë përdoret salla. Pra duhet të keni parasysh që ka një kontratë të marrjes me qera, por pagesa bëhet sa herë që kjo sallë përdoret nga ana jonë. Për vitin që shkoi në p.sh. nuk zhvilluam asnjë mbledhje për arsye rikonstruksioni, dhe nuk bëmë asnjë pagesë pavarësisht se kishim kontratë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Kam një pyetje. Në material thuhet deri në vitin 2026. Kaq kohë duhet të marrë rikonstruksioni i sallës suaj.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë Elbasan

Jo thuhet për vitin 2023-2024.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Ndoshta e kam parë gabim. Por nëse Bashkia zotëron të gjitha kapacitetet e mundshme për të organizuar takimet e mbledhjet e saj, sikurse kjo sallë këtu që është në juridiksion të Bashkisë, përse duhen godina private? Sepse këtu le vend për abuzim kur ju keni sallën e mbledhjeve tek shkolla “Luigj Gurakuqi”, keni

sallën e Qendrës Rinore, keni Bashkinë në rikonstruksion, përse duhen këto pagesa ekstra për një sallë që mund ta marrë privati jo një institucion shtetëor, sepse më duket absurde dhe nuk është se mungojnë ambjentet.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë Elbasan

Këtë jam duke ju shpjeguar, që kjo sallë merret me qera për një periudhë 1 vjecare dhe paguhet vetëm për rastet kur ka domosdoshmëri për përdorimin e saj. Pra jam duke shpjeguar se në raste ekstreme kur kjo sallë është e zënë me aktivitete dhe salla tjetër me një aktivitet tjetër, ne nuk kemi ku ta zhvillojmë mbledhjen, dhe e zhvillojmë tek kjo sallë. Por pagesa bëhet vetëm për këto raste ekstreme dhe nuk bëhet pagesë muaj për muaj. Po ta keni lexuar materialin ne e kemi shpjeguar shumë qartë këtë gjë. Në kontratën e kemi pasur edhe për vitin 2023 por nuk e kemi shfrytëzuar asnjëherë. Këtë jam duke ju shpjeguar, që në momentin kur të mbarojë mobilimi i sallës së madhe në godinën e re të Bashkisë, kjo kontratë do të ndërpritet menjëherë. Pra ky është një material për marrjen e masave paraprake për domosdoshmërinë e zhvillimit të mbledhjeve në rastet ekstreme, dhe nuk ka asnjë efekt financiar.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Jo, jo, bëhen thjesht për letra, nuk asnjë efekt financiar...

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me **41 vota pro**, 1 kundër, abstenim nuk ka - miraton sa më sipër. (Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike vjen këshilltari Blendi Himci i cili nuk ishte prezent tek 4 pikat e para, dhe mbas mbarimit të votimit largohet nga salla Armonela Marku).

Votoi kundër – Valbona Balliu

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 6-të dhe e 7-të e rendit të ditës -

Pika 6-të- Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Qemal Myrteza Gëzhilli, banor në lagjen “Dyli Haxhire”, nr. 3 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan.

Pika 7-të- Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Agim Nezir Mema, banor në lagjen “28 Nëntori”, nr. 3 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan.

Rexhep Kaculi – Kryetar i Komisionit të Shërbimeve dhe Strehimit Social, Shëndetësisë dhe Barazisë Gjinore.

Në komision u panë të dy materialet e pikës 6 dhe pikës 7. Përlllogaritjet janë bërë nga grupi i punës, jemi dakord të miratohen.

Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak.

Përsa i përket pikës 6 dhe pikës 7 unë kam një shqetësim që lidhen me këto dy pika për dëmshpërblimet që i janë caktuar qytetarëve. Në fshatrat Hajdaran, Mlizë dhe Polis i Vogël, ka persona që janë ankuar, pra më kanë shprehur shqetësimin e tyre, për një vendim të Këshillit të Komunës për një dëmshpërblim për dëmtimin e banesave nga rrëshqitja e tokës që në vitin 2015 që dhe sot e kësaj dite nuk kanë shtëpi, pra nuk është ekzekutuar si vendim. Një pjesë e tyre më kanë thënë që për shkak të mungesës së azhornimit të tokave, nuk kanë qënë në gjendje që të paraqesin një tapi toke për ndërtimin e shtëpive, por ka dhe nga ata që thonë që kanë marrë leje ndërtimi, por akoma nuk e kanë marrë këtë dëmshpërblim. Ju lutem që për mbledhjen e ardhshme, se ndoshta këtë mbledhje keni ardh të pa

përgatitur, dua një informacion për këto vendime komunare të vitit 2015 për dëmshpërblimin familje që i është dëmtuar banesa nga rrëshqitja e dheut. Ndoshta herës tjetër vinë dhe vetë të interesuarit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Me rastet konkrete unë jam në dijeni, për këto vendime për dëmshpërblimin e banorëve, dhe kur këto vendime u bënë gati për tu ekzekutuar, ndodhi pandemia, ndërkohë që ka dhe disa ligje e rregulla që disa familje nuk i plotësojnë. Pra për të ndërtuar një shtëpi duhet leja e ndërtimit gjë të cilën banorët nuk e marrin dot dhe kam frikë se edhe dëmshpërblimin nuk do e marrin dot.

Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak.

Le tia lemë mbledhjes tjetër dhe meqë jemi këtu kur të votohet pika 7 unë po e deklaroj votën time pro.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me 37 vota pro, kundër, abstenim nuk ka - miraton sa më sipër.

V.O.(Valbona Balliu, Artan Kana, Doris Madhi, Erion Murataj nuk kanë votuar, Armonela Marku nuk është prezente në votim).

Erion Murataj – antar im këshillit bashkiak.

Kam një pyetje për sekretariatën, me sa vota është votuar pika 7. Meqë proces verbalet e mbledhjes së kaluar nuk i kemi këtu, dhe ka dy herë që në proces verbale nuk ka pasqyrim të drejt të mbledhjes, dua informacion me sa vota ka kaluar pika 7, dhe secila pikë.

Hektor Ciftja – antar i këshillit bashkiak.

Ka kaluar me shumicë votash.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Duhet t'i kishe numëruar votat ti, se sot nuk kemi as transmetimin live të mbledhjes, dhe nuk mund ta shikojmë kush votoi dhe kush nuk votoi.

Blendi Himci - antar i këshillit bashkiak, kryetar i BF.

Përsërite edhe një herë votimin.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Unë e përsëris votimin, por ndërkohë që kjo nuk ka asnjë votë kundër asnjë abstenim nuk ka kuptim.

Erion Murataj – antar im këshillit bashkiak.

Me sa vota kaloi, kaq duam të dimë. Nesër do zbardhet proces verbali, a do shënohet numri i votave?

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Z. Lala është kërkësë e vazhdueshme, futeni këshillin bashkiak në suazën institucionale. Procedura është procedurë, sepse kjo është problematikë e vazhdueshme në të gjithë funksionimin e këshillit bashkiak. Çedon tek procedura, sepse për procedurë po futen njerzit në burg zotëri. Atëherë procedura është shumë e rëndësishme, deri sa jeni aty dhe deri sa keni një sekretariat që paguhet sa specialisti më i lartë në Bashki, ju lutem duhet të funksionojë si duhet. Kaq po kërkojmë thjesht t'i nënshtrohemi çështjes procedurale. Procedura është procedurë. Këtu nuk jemi as për t'u zgërdhirë aty, paguhet pikërisht për të mbikqyrur këtë proces, se fundja mbledhja e këshillit bashkiak është definimi i gjithë procesit të këshillit bashkiak. Dhe ata zotërinjtë atje duke nisur nga ai djali atje dhe të gjithë të tjerët për këtë paguhen, për mbarëvajtjen e këtij procesi, nuk paguhen as se janë të bukur, as se janë të mencur shumë, pikërisht për mbarvajtjen e këtij procesi. Futeni këshillin bashkiak në suazën institucionale, që ne të mos kemi përplasje me njëri tjetrin, dhe të mos kemi diskutime as jashtë rradhe, sepse sa bukur e the nuk numërova votën time ,pra ishin 26 që me votën tënde bënin 26, prapë nuk e kishe kourumin se është 50 +1. Zotëri disa çështje pika a, b, dhe c duhet të kalojnë me shumicë të cilësuar, ndërsa të tjerat nuk duan shumicë absolute. Të lutem fute këshillin në suazë ose detyroi këshilltarët e tu të vijnë të votojnë kur duhet shumica votave.

Hektor Ciftja – antar i këshillit bashkiak.

Unë mendoj ta përsëritësh prapë votimin e të numërohen votat edhe njëherë.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Zoti kryetar, pse mbledhja sot nuk po transmetohet live. Transmetimi live ka dicka, kurse regjistrimi është dicka tjetër, sepse montohet, cmontohet, rregullohet.

Altin Mecja – antar i këshillit bashkiak

Është pjesë e rregullores që mbledhjet të transmetohen live.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 8-të e rendit të ditës Për një shtesë në vendimin nr.83, datë 13.09.2023 të Këshilli Bashkiak.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë Elbasan

Këtu bëhet fjalë për punonjës me kohë të pjesshme, si sinjalizues, furnizues, të cilët punojnë me kohë të pjesshme jo gjatë gjithë vitit, që ishte tek parashikimi i ligjit për pyjet, dhe këta nuk janë tëk numri i përgjithshëm por meqënëse Agjensia është ndarë bëhet fjalë për efekte të përlogaritjes së pagave, prandaj është e nevojshme të futen në këshill.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me **31 vota pro, 1 kundër**, 7 abstenim nuk ka - miraton sa më sipër.

Votoi kundër – Valbona Balliu

Abstenuan – Doris Madhi, Dritan Ceca, Rudina Mita, Mimoza Trimi, Aurora Domni, Bjanka Copja, Altin Mecja.

V.O. (Blendi Himci, Amarda Murati nuk votuan, Armonela Marku nuk ishte prezent në votim)

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 9-të e rendit të ditës - Për miratimin në parim të Planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Gjinar, Zavalinë dhe Zallit Shkumbin.

Indrit Abdaj – Kryetar i komisionit mjedisit, bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, menaxhimit ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Janë hartuar këto planë të mbarështimit të ekonomisë pyjore ekonomisë pyjore, dhe dihet sa i rëndësishëm është plani për mbarvajtjen dhe shfrytëzimin e këtyre ekonomive. Ky plan është i një rëndësie për planifikimin e zbatimin në të gjitha aktivitetet nëntokësore fizike të sipërfaqes së ekonomisë pyjore. Nëse duhet informacion i detajuar nga stafi që mund ta japë këtë informacion gjithësesi nga drafti, nga të ardhurat në vazhdim të ekonomive pyjore të cilat paraqesin këtu një miratim paraprak, paraqesin një sërë informacionesh të nevojshme për gjendjen e grumbujve pyjore e kullosore si dhe masave të parashikuara për periudhën 10 vjecare të ndërhyrjeve të mundshme për përmirësimin e gjendjes aktuale, dhe punësimin e banorë të Bashkisë Elbasan, në produkte bujqësore dhe prodhime të dyta pyjore.. Kështu për sa më sipër kërkojmë të miratohet në parim hartimi i këtij plani të mbarështimit të ekonomisë pyjore Gjinar-Zavalinë e Zallit Shkumbin.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak.

Atëherë dicka kisha, këtu flasim për hartim për çështje të mbarështimit të pyjeve, dhe sigurisht këtu është zgjedhur një kompani nga bashkimi i dy kompanive.. Si ka ardhur kjo kompani për të hartuar, përpiluar dhe pse nuk ka pasur një tjetër. Një pyetje kisha si është përzgjedhur kjo kompani, dhe është përzgjedhur si fituese.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë Elbasan

Kjo kompani ka ardhur nëpërmjet procedurave të prokurimit publik dhe është përzgjedhur fituese.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me **33 vota pro, 3 kundër, 1 abstenim** miraton sa më sipër.

Votuan kundër – Lumturi Hasa, Erion Murataj, Doris Madhi.

Abstenuan – Dritan Cepa.

V.O. (Blendi Himci, Rudina Mita, Altin Mecja nuk kanë votuar, Armonela Marku, Valbona Balliu nuk ishin prezent në votim).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 10-të e rendit të ditës - Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr. 28, datë 26.02.2020 “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik për ndërtimin e HEC BUKANIKU, në përroin e qershisë.”

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Është i njëjti material që është shpjeguar dhe herën e kaluar. Nuk ka shtesa dhe ndryshime, dhe nuk ka pasur kërkesa për shtesa dhe ndryshime. Thjesht ligji, rregullorja nuk kanë kufizim për sa herë një material mund të paraqitet për sa kohë ky material në total mund të votohet kundër, dhe kur nuk ka material shtesë të karkuar, administrata si procedurë e rifut këtë material.

Bjanka Copja – antare e këshillit bashkiak.

Kur rrëzohet një vendim mund të futet cdo herë, në cdo mbledhje?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Nuk ka ndryshim midis një vendimi të kërkuar dhe një vendimi që nuk ka marrë shumicën e votave.

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak.

E ka një arsye pse ky material nuk u miratua. Mbase ka dashur material shtesë.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Nuk ka pasur kërkesa për ndryshim material, por ligji nuk e pengon të rifutet sa herë që një material nuk merr shumicën e kërkuar.

Iirjan Sadiku – antar i këshillit bashkiak.

Edhe mendimi ndryshon, mund të evoluojë nga mbledhja në mbledhje.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ky material ka lidhje me një vendim që është marrë që në vitin 2020. Gjatë kesaj kohe, duke marrë shkas nga kërkesa e subjektit për llogaritjet gabim në sipërfaqe e metër linear, është bërë verifikimi nga Drejtoria Pyjeve me seksionet përkatëse për saktësim të kesaj sipërfaqeje.

Kush ka pyetje?

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak voton 30 vota pro.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Të jemi më të saktë, ta votojmë edhe një herë pasi ky material do miratimin e 3/5 të anëtarëve të këshillit.

Këshilli bashkiak me 30 vota pro, 4 kundër, 7 abstenime nuk e kalon materialin e mësipërm. (Nuk ka votat e duhura 3/5, pra 31 vota).

Votuan Kundër – Sokol Sinani, Lumturi Hasa, Arbi Fetah, Erjon Murataj.

Abstenuan – Aurora Domni, Bjanka Copja, Altin Mecja, Rudina Mita, Doris Madhi, Valbona Balliu, Zamir Muzhaqi.

V.O. Armonela Marku nuk është prezent ne votim).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 11 -të e rendit të ditës - Për dhënien e dakortësisë nga Këshilli Bashkiak, me qëllim lidhjen e kontratë qerasë me subjektet të dal fitues në procedurat e prokurimit publik. “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”

Indrit Abdiaj – Kryetar i komisionit mjedisit, bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, menaxhimit ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Ne patëm një diskutim në komision dhe aty erdhi relacioni nga këshilli për 3 materiale ose te jemi me të saktë për 3 stacione të vecanta ne pyje, në ekonomitë pyjore, një në Papër Sollak, dhe në zallin Shkumbin, duke qënë se që në fillim ato duhet të jenë të vecanta gjithmonë dhe ne kërkuan të paraqiten të vecanta, pra vec e vec, dhe përvec kësaj doli problematika e Zallit shkumbin që është subjekti “Energypeak” sh.p.k, , ku ne patëm një informacion rezaures. Kurse për dy stacionet e tjera të cilat përvec se kanë një sipërfaqe shumë të madhe përta i përket zonës atje, që ishte rreth 120 ha, dhe patjetër ajo ajo mund të cënojë banorët e zonës ose gjëra të tjera që lidhen me banorët e zonës, kështu që ne propozojmë që për këto të dyja të mos hynë në këshill por të vijë një informacion rezaures. Ndërsa për subjektin energjitik në zallin shkumbin mendum që të hyjë në këshill. Pra ne për këtë ftojmë këshillin për miratim, kurse për sipërfaqet e tjera besoj janë shumë të mëdha. Ftoj këshillin ta votojnë.

Ergys Muzhaqi – antar i këshullit bashkiak.

I bie të shtyhet për herën tjetër.

Dritan Cepa – antar i këshillit bashkiak.

Duhet ndarë materiali.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Ne e kemi respektuar këtë, dhe për të qënë transparent kemi lënë edhe materialin e parë, ndërkohë kemi futur materialin e dytë. Por meqënëse këto sipërfaqe janë problematike, materiali u nda në dy pjesë dhe për pjesën tjetër ka pasur kërkesë për plotësim dokumentacioni, dhe ne e kemi tërhequr mbrapsh materialin për ta rishikuar, gjë që është reflektuar në relacionin me Nr 5915/1 duke respektuar konkluzionet e relacionit të komisionit të pyjeve dhe mjedisit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Është ndarë relacioni?

Indrit Abdiaj – Kryetar i komisionit mjedisit, bujqësisë,veterinarisë, pyjeve,menaxhimit ujrave,mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Relacioni është ndarë sic po sqaron edhe N/Kryetarja e Bashkisë.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Që të jemi të qartë do votohet relacioni me Nr Prot. 5915/1.

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Pse nuk është identifikuar në pikën 11 që është për vendosje stacionesh fotovoltaike, kur është ndarë? Kur është ndarë po thëm pse nuk është përcaktuar?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Është reflektuar, pra materialit të pikës 11 me Nr prot 5915 i është bashkangjitur materiali me Nr 5915/1.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Sërish po ndalem tek çështja procedurale. Komisioni përbehet nga Indrit Abdiaj, Shpëtim Llapushi, dhe Naim Meta. Njëra firmë mungon. Ne relacion thuhet dhe me miratimin e anëtarëve të tjerë të komisionit.Ka firmosur Indrit Abdiaj, Shpëtim Llapushi, Naim Meta nuk ka firmosur

Bjanka Copja – antare e keshillit bashkiak.

Naim Meta ka qënë dakord.Kur ne e diskutuam në komision Naim Meta ka qënë dakort, gjithsesi të flasim dhe të tjerët.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Po flasim për dicka të shkruar. Nëse Naim Meta ka qenë dakord duhej ta reflektonte në proces verbal, aq më tepër që ai sot nuk është prezent në sallë. Pra kanë firmosur vetëm 2, i treti nuk ka firmosur. Pse nuk ka firmosur, ta aargumentojë.

Indrit Abdaj – Kryetar i komisionit mjedisit, bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, menaxhimit ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Proces verbali është firmosur nga kryetari komisionit dhe sekretari i tij.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Komisioni ka 7 anëtarë, janë 3 dakord kanë firmosur vetëm 2.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Pra janë të 3 dakort e firmosin vetëm 2, shikojini me kujdes shkresat kur i hartoni. Se i bie që zotëria ose nuk ka qënë fare në komision ose po të kishte qënë në komision do ta kishte firmosur proces verbalin.

Bjanka Copja – antare e keshillit bashkiak.

Pa problem se në mbledhjen e ardhshme do ta kesh prezent.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Z. Naim Meta nuk ka firmë, shikoje, nuk ka firmosur dhe nuk është dhe prezent në sallë që të jetë në gjëndje të na i argumentojë, prandaj fjala juaj është e pavlefshme dhe nuk keni pse ta mbronni sepse nuk jeni avokate e Naim Metës, nuk keni prokurë ligjore për ta përfaqësuar. Ju lutem veproni institucionalisht, ose ta shtyni për herën tjetër, sepse ky vendim i komisionit është i pa vlefshëm.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Po bëni një debat që nuk shkon, ky material është ndarë nga ajo pjesë e materialit që nuk i përmbushte kërkesat pra kishte nevojë për plotësim dokumentacioni, sipas relacionit të komisionit, ndërsa pjesa tjetër përderi sa nuk ka asnjë ankesë, edhe komisioni mund të mos kishte referuar dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore. Kjo për procedurë.

Indrit Abdaj – Kryetar i komisionit mjedisit, bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, menaxhimit ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Bëhet fjalë për ngastrat 25/a, 28/a, 29/c 30/ab për ekonominë pyjore “Zalli Shkumbin”.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ta shtyjme për herën tjetër?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

A ka një rregullore këtu? Të nxirret rregullorja.

Ilirjan Sadiku – antar i këshillit bashkiak.

Materiali që do votohet është vec ne e kemi para në dosje. Pse të mos votohet? Këtu bëhet fjalë pr miljona euro investime dhe ne i kalojmë kështu. Bëhet fjalë për 13 milion euro investime për Elbasanin

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Si mund të kalojnë kaq kollaj, cfare jemi ne këtu. Të paktën letrat të jenë në rregull. Si kalojnë materialet kaq hehtësisht. Kaloi...por si kaloi, cfare është kjo këtu, cfare janë këta njerëz?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Hidhe këtë pikë në votim, dhe me vota po kaloi, kalon, po nuk kaloi këtë e tregon votimi.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Po si do kalojë kur procedura është gabim, kur ke mangësi në dokumentacion?

Shefqet Bullari – antar i këshillit bashkiak.

Unë e njoh zonën atje, është grykë dhe zallishte. Atje përvec investimit të fuqishëm që po e përmend edhe Z. Ilirjan, atje është vetëm zallishte, dhe kjo që po bëhet mbron dhe tokën e fshatit Balldren. Kjo tokë të mos shkojë dëm por ska asgjë të keqe të shfrytëzohet.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Kjo besoj kërkon 3/5 e votave.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, e kalon këtë material.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Më falni zotëri me sa vota kalon ky material? Ti numërojë votat se për atë paguhet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh edhe njëherë në votim materialin .


Këshilli bashkiak me **32 vota pro**, kundër ska, 8 Abstenime e miraton këtë material.

Abstenuan - Doris Madhi, Dritan Cepa, Valbona Balliu, Amarda Murati Lumturi Hasa, Erion Murataj, Rudina Mita, Altin Mecja.

V.O. Aurora Domni, nuk votoi, Armonela Marku nuk ishte prezent në votim).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 12-të dhe 12/1 e rendit të ditës –

Pika 12-të - Detajim i shtesës së fondeve nga transferta sektoriale dhe transferim fonde nga te ardhurat

Pika 12/1- Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2023.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Atëherë po e shpjegoj unë këtë material. Në bazë të ligjit për krijimin e njësive të reja tek Agjensia e Kulturës e Turizmit dhe Agjensia e Pyjeve e mjedisit, për efekt të transferimit të pagave, sepse sic e thamë janë njësi të krijuara nga riorganizimi i brendshëm, dhe për këto njësi e pozicione të krijuara është e nevojshme për efekt të kalimit të planit të pagave të bëhet transferimi nga atje ku kanë qënë në njësinë e krijuar nga riorganizimi.

Dhe pika tjetër ka të bëjë me blidhjen e kursimeve të prokurimeve, të cilat do të përdoren për blerje pajisje për zyrat për godinën e Bashkisë. Pra janë akumuluar kursime nga prokurime të ndryshme dhe e njehta gjë është dhe për 2023 tek një zë që ka qënë blerje kënd lojrash që është në procedurë shpronësimi e cila nuk ka përfunduar akoma, sepse është në Agjensinë Shtetërore të Shpronësimeve, dhe kanë kaluar në ambjentet e ish-AShP-se e cila do kthehet në Agjensinë Publike.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pra është bërë transferim fondi. Pyetje ka?

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Kam unë një pyetje. Bëhët fjale për transferimin e këtij fondi, për rikonstruksionin e APSH-së. Ju keni thënë pakësohet shuma për rikonstruksionin e Rrugës “Marie Duda. Atëherë si rezulton ky pakësim, pra ju keni tenderuar firmën me shumën më të madhe dhe këtu kanë tepruar para të cilat firma ia kthen buxhetit të Bashkisë, apo pezullon punimet aktuale që janë pa kryer në Rrugën “Marie Duda dhe Hamdi Roseni”. A janë mbaruar, pra ka mbaruar rikonstruksioni i tyre, apo janë në procedure rikonstruksioni? Kjo është e para.

Dhe e dyta që kisha – Blerje kënd lojrash. Ky kënd lojrash që i shërben komunitetit, se fundja me taksat e komunitetit mbaheni ju, pra ky investim për këtë kënd lojrash shkon për blerje pajisje zyresh? Ka llogjikë kjo? Unë këtë dua të ma thuash. Pra është blëre ky kënd lojrash dhe këto para janë kursyer sepse e keni gjetur këndin më të lirë, apo firma e ka bërë rrugën me një buxhet më të kufizuar dhe ka bllokuar këto para apo ju këto i pakësoni nga fondet e parashikuara për shërbimet publike? Këto fonde dua të më shpjegoni.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Po jua shpjegoj menjëherë. Kursimet janë nga.....

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Këtu lexon pakësim, jo kursim. Paksimet janë kur ju e keni pakësuar fondin.. A është rialokuar ky fond?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Pakësimi është term financiar. Kur të mbaroni do jua shpjegoj.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Unë do mbaroj dhe ju do më dëgjoni me vëmëndje të lutem, dhe hiqeni arrogancën e shtetarit, sepse jeni aty dhe për llogaridhënie. Zonjë dua ta di, këto janë dy investime publike, njëra për rrugë dhe tjetra për kënd lojrash për fëmijë. Atëherë dua ta di si kanë tepruar këto para që i kalojnë administratës. Administrata nuk pjaftohet vetëm me pagat e larta por do dhe kushte, dhe i lihen qytetarëve mungesa në kënde lojrash dhe mbarime inve **Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan**

E para duhet të biem dakord të jemi më të qetë në diskutime dhe të merremi vesh më mirë, se kur jemi më të qetë dëgjojmë më me vëmëndje, dhe nuk krijojmë një lloj trazire...

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Këto janë pyetje normale. Një farë cinizmi kur përgjigjeni reflektohet edhe tek ne në kundërpërgjigje pastaj. Ju lutem te jeni dhe ju më të përparuar se jeni punonjës shteti.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Arsyeja pse është përcaktuar termi pakësime, është se këto janë terma financiare që përdoren – “pakësohet”....

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Ju lutem mos u kapni në terminologji. Dua të di si është pakësuar. Ka mbaruar investimi apo jo.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Ky paksim është bërë në këto dy objekte për shkak të kursimit nga procedura e prokurimit. Kur një investim hidhet në sistemin e prokurimit publik, hidhet me vlerën e preventivit të hartuar nga inxhinjerë përkatës duke iu referuar cmimeve të manualit të ndërtimit. Me hyrjen në konkurim të subjekteve zbatuese për të përfituar këtë kontratë, në shumicën e raste sigurisht që ato hynë për të konkuruar dhe hynë me cmime më të ulta. Diferenca që krijohet që prej fondit limit deri kur sistemi prokurimit publik me kontratën e lidhur me operatorin fitues quhet diference. Dhe këtë ne në terma financiarë e quajmë, pakësohet nga ky zë dhe shtohet në zërin tjetër. Besoj isha shumë e qartë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Atëherë rikonstrukcioni i gjendjes faktike të rrugës, është nisur apo jo?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Ka përfunduar.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Atëherë këto rrugë kanë përfunduar plotësisht, po këndi i lojrave është vënë në funksion, që ne të dyja të shkojmë ta shohim?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Unë për këndin e lojrave e shpjegova dhe në fillim. Është një investim i parashikuar në buxhet, dhe territori ku do bëhet ky kënd lojrash ka dhe pjesë privatë dhe ne kemi nisur procedurat e shpronësimit, dhe për këtë nuk mund ta vendosim, nuk mund ta blemë pa përfunduar kjo procedurë e shpronësimit, sepse nuk mund të cënojmë pa një VKM të shpronësimit, një pronë private. Duke parë kohën në të cilën ne jemi duke parë që ky kënd nuk mund të realizohet, Bashkia ka

rialokuar këtë fond për dicka tjetër që ka nevojë, pra për krijimin e zyrave të Agjensisë Publike.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Pse nuk shtoni një fond tjetër e ta shpronësoni, por shfrytëzoni këndin e lojrave për rikonstruksione zyrash?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Ne kemi përfunduar shumë kënde lojrash për fëmijë, da vazhdojmë të bëjmë edhe të tjerë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Ku janë këto kënde lojrash për fëmijë Aulona, se jetojmë në të njëjtin qytet. Unë nuk jetoj në Tiranë, as ti, ku janë pra këto kënde?

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Ka pra ka, Një është në qendër të qytetit, një tek Parku Rinia, një tek Pallati Sportit.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Ajo tek Parku Rinia është ndërtuar që në kohën e Qazim Sejdit, si dhe ai tek Pallati Sportit. Ne po flasim tani për këtë buxhet, se e dimë ne se kur janë bërë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak **me 35 vota pro, 1 kundër, 4 abstenime** - miraton sa më sipër.

Votoi kundër – Valbona Balliu

Abstenon – (Aurora Domni, Bjanka Copja, Artan Kana, Rudina Mita).

V.O. (Blendi Himci – nuk votoi, Armonela Marku nuk është pezant në votim).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 13 –të dhe 14-të e rendit të ditës –

Pika 13 –të - Për vendosjen në qendrën rezidenciale Qendra Balashe të Z. Bardhul Zabzuni

Pika 14-të - Për vendosjen në qendrën rezidenciale Qendra Balashe të Zj. Farije Kovaci.

Rexhep Kaculi – Kryetar i Komisionit të Shërbimeve dhe Strehimit Social, Shëndetësisë dhe Barazisë Gjinore.

Në komision u diskutuan të dy materialet dhe komisioni ishte dakord.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin .

Këshilli bashkiak me **40 vota pro**, kundër, abstenim nuk ka - miraton sa më sipër.

V.O. (Blendi Himci – nuk votoi, Armonela Marku, nuk ishte prezent në votim).

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.10.2023 , ora 11:20 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, N/Kryetarja e Bashkisë Zj. Vesa Lico, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 1 –rë tek të n dryshmet e rendit të ditës - Informacion për zgjedhjen e kryetarëve dhe kryesive së fshatrave në 12 Njëitë administrative të Bsshkisë Elbasan.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Lexon informacionin.

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak.

A ka përsëritje të zgjedhjeve për 2 fshatrat për shkak të parregullsive ne procesin e votimit për zgjedhjet e kryetarëve e kryesive ne fshatra? A ka ndonjë vendim marrje për këtë. . Po ju lajmëroj se për gjithë pjesën procedurale nga nisja e procesit e deri në pjesën e parregullsive në disa fshatra i kam konstatuar unë si antar komisioni, dhe për këtë do paraqis pranë institucioneve përkatëse kërkesën për fallsifikimet përkatëse për parregullsitë dhe pavlefshmërinë e procesit. Nuk më ka ardhur asnjë dokumentacion. Kam kërkuar informacion nga kryetari Njësisë Administrative Bradashesh, Njësia Administrative Kuqan dhe Njësia Administrative Labinot, por asnjë nuk më ka dhënë informacion. Kjo shkelje procedurale do jetë objekt ankimi.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak, kryetar i grupit të BF.

Unë besoj se mbledhja e Këshillit Bashkiak është evenimenti më i rëndësishëm politik, mujor për Bashkinë Elbasan, dhe duhet t'i japim rëndësinë e duhur kësaj mbledhje, sepse nuk është një mbledhje përplasjesh të partive politike, por është një mbledhje vendimmarrjeje për interesin e qytetarëve elbasanas. Sigurisht ne jemi pozicionuar sipas kampeve politike, por ajo që më intereson është që vazhdohet i

njëti ritual 4 vjecar i mëparshëm, më një lloj mungese transparence të mbledhjes së këshillit bashkiak. Nuk mundet që vetëm një kameraman i Bashkisë të transmetojë këtë mbledhje aq më tepër që nuk është live, nuk mundet që ju si kryetar i këshillit bashkiak të mos ftoni të gjitha mediat. Këtu duhet të jenë të gjitha mediat të pranishme. Kjo duhet të bëhet publike, cdo vendim marrje e qytetit. Nuk mbahen kaq të fshehta vendim marret e qytetit. Për ceshtje të transparencës si institucion, e ka detyrë funksionale Bashkia të informojë qytetarët për vendim marrjet. Pra duhet të jenë të gjithë të informuar, jo vetëm nëpërmjet televizionit por edhe gjithë rrjeteve sociale. Sa më shumë transparencë aq më e duhura është nga ana e Bashkisë të paraqesë punën e saj. Prandaj do të kërkoja sepse u bë i disati rast. Njëherë diskutohen problemet teknike, sepse sot ka gozha probleme teknike. Nuk mund të lihet kjo lloj situatë kështu. E them këtë për t'i dhënë autoritetin e duhur. Ne nuk jemi këtu brigadë, apo mbledhje kooperative, e ritheksoj është mbledhja më e rëndësishme dhe ngjarja më e rëndësishme e qytetit. Ju lutem të kthehet në institucionalitetin e duhur, të vijë dhe kryetari i bashkisë, sepse vetëm një mbledhje ka ardhur, tek mbledhja e parë që bëri betimin dhe një mbledhje tjetër. Por betimi nuk quhet. Nuk mund të sfidohet nga ana e kryetarit të bashkisë, këshilli bashkiak. E them këtë sepse duhet t'i japim autoritetin e duhur këshillit, pasi është parlamenti i qytetit. Unë besoj se duhet të jemi të gjithë ne si këshilltarë në këtë lloj statute për të bërë më të mirën për qytetarët e Elbasanit. Faleminderit.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Mund të shtoj dhe dicka. Projekt vendimet dhe vendimet si dhe proces verbalet e mbledhjeve të këshillit bashkiak, duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë. Por këtu duhet kujdes, jo me datën që supozohet që duhet të ishin hedhur, por me datën reale që hidhen. P.sh. proces verbalet e mbledhjeve të muajit Korrik dhe Gusht janë miratuar në mbledhjen e datës 5 tetor. Shkoj në faqen e këshillit bashkiak dhe mrekullisht i gjej sikur gjoja janë hedhur në muajin gusht. Mos bëni përpjekje të dëshpëruara për t'iu përshtatur kriterëve. Bëjeni gjënë transparente. Elvi me ty e kam, bëjeni gjënë transparente edhe po u hodh në kohën e gabuar sepse fillon me gjëra të vogla dhe përfundon me gjëra shumë më të mëdha dhe që kanë një impakt më negativ se kurrë.

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i këshillit bashkiak.

Problemet proceduriale janë evidente. Mbledhjet e këshillit bashkiak kanë shumë probleme proceduriale. Fillon mbledhja, mbaron mbledhja po me probleme proceduriale. Rregullorja e ka që mbledhjet e këshillit bashkiak duhet të transmetohen live, dhe nuk ka pse për mungesë të njërit apo tjetrit mbledhjet të mos transmetohen live. Unë besoj këto gjëra duhen rezauruar njëherë e mirë sepse u

bë e pesta apo e gjashta herë që mbledhemi dhe diskutojmë të njëjtat gjëra..Kam përshtypjen që e kam bërë këtë diskutim pak a shumë por në një formë ndryshe, në mbledhjen e dytë të këshillit bashkiak.Besoj nga ana jonë nuk do të ketë më tolerime të tilla në shkelje të rregullores apo ligjit, se si u mblodh këshilli bashkiak, si funksionon këshilli bashkiak, apo si duhet të procedohet. Meqë e mora fjalën doja t'ju kujtoj me modesti sepse të gjithë e dimë që jemi në muajin Nëntor dhe është muaji i miratimit të buxhetit për vitin 2024 i cili ka dhe disa procedura të cilat duhet të ndiqen dhe unë doja ta kujtoja sot për të vetmen arsye që kur të vijë çështja e buxhetit, të diskutojmë buxhetin dhe jo të merremi pse nuk u bë takimi me qytetarë, pse nuk iu dha materiali këshilltarëve,pse nuk erdhi në kohë grafiku i konsultimeve me publikun etj. Kështu që do të doja t'i paraprimë veprimeve të muajit pasardhës si dhe zbatimit të afateve ligjore, në zbatim të rregullores së këshillit bashkiak. Të krijohen të gjitha kushtet për pjesmarrjen e publikut në dëgjuesat publike, të kemi një bashkëpunim të mirë në këtë drejtim që dhe konsultimet publike të jenë sa më të gjëra. Të ngarkohen proces verbalet në faqen e Eëbit të Bashkisë. Të vihet në dispozicion buxheti për qytetarët, të respektohen afatet e detyrimet ligjore.

Lumturi Hasa – antare e këshillit bashkiak

Unë kam nja dy ankesa, e para është për banorët e Lagjes “Shënkoll” që kanë disa vjet që kanë bërë ankesë për ujrën e zeza, për mungesë tubacioni. I janë drejtuar Bashkisë dhe cdo lloj institucioni dhe nuk është marrë në konsideratë kjo gjë.Aty jetojnë dhe familjarët e mi dhe kam gati një vit që nuk i shkoj në shtëpi për arsye të ndotjes dhe erës së keqe. Kjo mirë që është ndotje e qytetit, por ata që jetojnë aty si i bëhet?Do doja që kjo të merrëj goxha në konsideratë, jo vetëm se jetojnë fam iljarët e mi, por edhe për të gjithë ata njerëz atje prej të cilëve unë jam sot këtu. Kjo është kërkesa më bazike. Kjo ishte e para.

E dyta është për invalidët e punës që nuk i njihet librezja për transportin urban.Pse duhen përjashtuar këta invalidë nga transporti urban. Është bërë ankesë herë pas here, një herë pranohen një herë s'pranohen.Ju lutem sepse cdokush nga ju ka në shtëpi nga një invalid.Pse trajtohen ndryshe invalidi i punës dhe ai që e ka humb këmbër këmbën prej diabetit? Kjo është bërë në mënyrë abuzive. Ata kanë bërë protesta herë pas here. Do doja që subjektit të “Krivës” t'i tërhiqet vëmëndja për këtë problem.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Në mbledhjen e ardhshme të ketë një informacion për këtë problem.

Indrit Abdiaj – antar i këshillit bashkiak

Është një kalendar për aktivitet e këshillit bashkiak, të shikohet me përparësi.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Mbledhja mbyllet në orën 13.05’.

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA